

Herën tjetër do të vij në shtetin e pavarur të Kosovës

Interviste ekskluzive për kombëtaren “Bota Sot” me albanologun e njohur Robert Elsie (3).

Takimi i parë, me një personalitet siç është dr. Robert Elsie, është një rast i veçantë. Një enciklopedi e tërë (kontributi i tij për historinë, kulturën, letërsinë dhe artin shqiptar) të lehtëson me thjeshtësinë e tij dhe përballesh me praninë “me kushtin” e të rinjohurit në një bashkëbisedim “pa doreza.” Dhe të ofron modestinë, thjeshtësinë që e bën edhe më madhështor qoftë edhe në pyetje “me kusht,” sepse albanologu i njohur në përmasa ndërkombëtare e ka përjetuar me vite dhe gëzon tani. Në vazhdimin e tretë të fundit, dr. Elsie flet për përkthimet etj., e mbi të gjitha se herën tjetër do të vijë në shtetin e pavarur të Kosovës.

[BS]: Përkthimet në Kosovë, por edhe në Shqipëri janë, siç mund të themi, përkthime të përkthimeve. Si e shihni fushën e përkthimit në Kosovë dhe në Shqipëri? Për shembull, vite më parë në Kosovë veprat e autorëve të njohur të letërsisë botërore kanë ardhur kryesisht nga serbokroatishtja, a në Shqipëri veprat e autorëve të letërsive “të vogla” vijnë nga përkthimet nga gjuhët e njohura. Përkthimi nga përkthimet?

[RE]: Po, përkthim i dyfishtë. Kjo është një dukuri shumë e përhapur në botën shqiptare. Dhe është për të ardhur keq. Shqiptarët interesohen shumë për letërsinë ndërkombëtare. Natyrisht kanë të drejtën, por mungojnë përkthyesit në përgjithësi për gjuhë të ndryshme dhe niveli i përkthimit është i dobët, sa kam vënë re unë. Jo gjithmonë. Ka edhe disa përkthyes të mirë. Shumica e përkthimeve të veprave letrare nuk janë me cilësi të duhur. Kjo gjithmonë ka qenë kështu. Përkthimet që janë bërë përpara, siç thatë Dostojevski, vinin nëpërmes serbokroatishtes, pastaj letërsia gjermane përmes anglishtes që bëhet edhe sot. Është gjynah sepse çdo përkthim shtrembëron tekstin. Për shembull në rastin më të mirë shtrembëron 15 për qind, gjithmonë do të ketë një shtrembërim të vogël. Por me përkthimin e dyfishtë mund të kemi lirisht 20 për qind të shtrembëruar në tekst. Detyrimisht është kjo një humbje e madhe. Çdo përkthim është një humbje. Kam thënë njëherë se të lexosh një vepër në përkthim është si të puthësh nusen me duvak. Nuk e kemi drejtpërdrejt, kemi një mur në mes. Duhet të bëhet më shumë në fushën e përkthimit. Për fat të keq mungon një shkollë e mirë e përkthimit të gjuhës shqipe deri tek interpretimi. Tani vonë kam dëgjuar që janë bërë përpjekje nëpërmjet një qendre në Strasburg për të krijuar një shkollë në lëmin e interpretimit dhe të përkthimit për gjuhën shqipe. Sapo ishte një delegacion i vogël këtu në Prishtinë, i cili më parë kishte qenë në Tiranë, por duket se hasi në probleme të ndryshme. Nuk ka një mirëkuptim për rëndësinë e problemit. Kontaktet e shqiptarëve me botën e jashtme realizohet kryesisht nëpërmjet përkthimit, nëpërmjet interpretimit. Dhe unë si interpret i gjuhës shqipe e kuptoj rëndësinë e kësaj fushe. Kështu që duhet bërë më shumë të krijohet një shkollë, mbase institut i përkthimit dhe interpretimit për gjuhën shqipe, në mënyrë që të kemi përkthyes të kualifikuar jo vetëm shqip-anglisht, por edhe me gjuhë të tjera kryesore, gjermanisht, italisht, spanjisht, frëngjisht, rusisht, etj., bile edhe kinezisht.

[BS]: Natyrisht që gjendja në Shqipëri është më e mirë?

[RE]: Disi më mirë, por njerëzit më thonë që shumica e përkthimeve letrare janë të dobëta nga cilësia e përkthimit, domethënë nga letërsia e huaj në shqip. Dhe në drejtimin tjetër, nga shqipja në gjuhë të huaj, është akoma më keq sepse ka shumë pak përkthyes.

[BS]: Shembull tjetër është se veprat e Kadaresë përkthehen në anglisht nga frëngjishtja.

[RE]: Po, po. Është për të ardhur keq. Nuk ka përkthyes që përkthejnë drejtpërdrejt nga shqipja. Ata janë të paktë, dhe meqë mungojnë detyrimisht duhet të bëhen përkthime të dyfishta.

[BS]: Në fund, diçka që doni të shtoni? Udhëtoni sot. Ta zëmë se nuk do të kthehesh ta kushtëzojmë për pesë vjet?

[RE]: Ha-ha-ha-ha. Nuk e paramendoj këtë që thoni. Ha-ha-ha-ha... Jam pak i pikëlluar që nuk jam këtu për ditën e Pavarësisë së Kosovës, sepse është një gjë që e kam pritur për një kohë shumë të gjatë. Kam vuajtur bashkë me Kosovën tërë kohën në të kaluarën. Dhe shoh se tani po afrohet dita. Po del atë që e kemi ëndërruar të gjithë. Jam shumë i gëzuar për këtë. Dhe shpresojmë kur të vij herën tjetër, do të vij në shtetin e pavarur të Kosovës. Jam i bindur për këtë. Dhe gëzohem që tani.

(10 shkurt 2008, Prishtinë)

Bashkëbisedoi: Enver S. Morina.

[botuar në / *Bota Sot*, Prishtinë, 16 shkurt 2008, f. 23 / published in: *Bota Sot*, Prishtina, 16 February 2008, p. 23.]